



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:258986  
Datë: 29.05.2024  
Numri i dokumentit: 05748065

**C-IV - 17 – 0445**

Paditës: B P nga Kllokoti,  
Kundër

**Të paditurës:** Ndërmarrja Shoqërore „ Banja e Kllokotit ” në likuidim të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, rr. ” Driton Hoxha ”, nr. 55.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me gjyqtarin Hasim Sogojeva, me dt. 27 maj 2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, B P me të cilin ka kërkuar të obligohet e paditura NSH „Banja e Kllokotit ”, të paguaj shumën 962 €, për dy paga në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës.**
- II. Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës.**

**Rrethanat Faktike dhe Procedurale**

Me 14.09.2017, në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës është parashtruar padia/ankesa e paditësit, kundër të paditurit me kërkesë që e paditura NSH „ Banja e Kllokotit ” të obligohet të paguaj shumën 962€, për dy paga në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës .

Në parashtrësë është deklaruar se ka qenë në marrëdhënia pune te e paditura NSH, por me rastin e vendosjes për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës atij me Vendim ju janë njohur dhe paguar vetëm për katër paga, ndërsa sipas Ligjit të punën nr. 03/L-212, atij është dashur ti njohën gjashtë paga . Ka kërkuar që për dy paga bruto të pa paguara ti paguhen në shumën 962€.

Me parashtrësë ka dorëzuar :

- Kërkesa e paditësit për Komisionin e Likuidimit dt. 31.08.2017,
- Vendimi i AL GJI 095- 0023, dt. 13.06.2013.

Më dt. 20.09.2017, AKP-ja, përmes përfaqësuesit të saj ka dorëzuar parashtresën në mbrojtje ndaj ankesë së ushtruar kundër Vendimit të AL GJI 095- 0023, dt. 13.06.2023 me propozim të refuzohet kërkesa

Në parashtresë është deklaruar se NSH „Banja e Klllokotit ” ka hyrë në procedurë të likuidimit, më dt. 08.11.2010, ndërsa paditësi ka ushtruar kërkesë kreditore më dt. 16.11.2010, me të cilën ka kërkuar dëmshpërblimin për ndërprerje të parakohshme të kontratë së punë së punës në shumën 1,736.00€.

Autoriteti i Likuidimit me Vendimin GJI 095- 023, dt. 13.06.2013, ka pranuar në tërësi kërkesëpadinë paditësit dhe atë për paga neto shumën 1,736.00€ dhe për kontribute në shumën 286.88€.

Në muajin shkurt të vitit 2017, Bordi i Drejtorëve i AKP-së, ka pranuar Raportin për Shpërndarje të Fondeve të Kreditorëve, përfitues i kësaj shpërndarje ishte edhe paditësi.

Më dt. 14.09.2017, paditësi ka dorëzuar te DHPGJS ankesën dhe për këtë ne kemi dorëzuar parashtresën në mbrojtje .

Në parashtresë është deklaruar se paditësi e ka pranuar Vendimin e Autoriteti të Likuidimit GJI 095- 0023, dt. 16.03.2013, dhe çfarëdo ankese e ushtruar në DHPGJS, pas 30 ditëve të pranimit të Vendimet është e pa pranueshme, sipas nenit 37.7 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034.

Përveç kësaj ankese kundër vendimit të AL 095- 0023, përveç që është e pas afatëshme ajo nuk ka bazë pasi kërkesa e paditësit është pranuar në tërësi, ashtu si është ushtuar .

Ka dorëzuar :

- Dëshminë për dorëzimin e Vendimet të AL GJI 095- 0023, dt. 13.06.2013, më dt. 19.06.2013, të nënshkruar nga paditësi,
- Formularin e kërkesës kreditore në shumën 1,736.00€ ,

Më dt. 01.12.2023, DHPGJS ka lëshuar Urdhër C- IV- 17- 0445, si për paditësin ashtu edhe për të paditurin për plotësimin e ankesës/padisë , sikundër edhe për të paditurin .

Më dt. 08.12.2023, Urdhrin e ka pranuar paditësi, ndërsa e paditura më dt. 01.12.2023.

Paditësi nuk ka vepruar sipas urdhrin për plotësimin e padisë .

Më dt. 12.12.2023, AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj ka dorëzuar parashtresën me të cilën ka dorëzuar provat :

- Vendimin e AL GJI095- 0023, dt. 13.06.2013,
- Njoftimi për likuidim dt. 01.12.2010,
- Aktvendimin SCC- 10- 0144 .

### **Arsyetimi Ligjor**

**Ankesa e paditësit, është e pa bazuar.**

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqës, dhe ka konstatuar se nuk është kontestuese fakti se paditësi ishte punëtor i të paditurës NSH „Banja e Klllokotit”, por paditësi nuk ka dorëzuar dëshmi për pranimin e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, sikundër edhe dëshmi për përvojën e punës.

Me formularin e kërkesës kreditore, dt. 16.11.2010, paditësi kishte kërkuar shumën 1,736.00€, në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës.

Me Vendimin e PRN GJI 095- 0023, të AL për NSH „Banja e Klllokotit” paditësit B P ju është pranuar kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën 1736.00€, para aq sa e ka kërkuar shumën.

Paditësi kishte dorëzuar kërkesën, para Autoritetit të Likuidimit më dt. 16.11.2010, në kohën kur në fuqi ka qenë Ligji Themelore i Punës – Rregullorja 2001/27.

Gjykata vlerëson se kërkesa e paditësit dt. 31.08.2017, për pagesën e dy pagave në shumën 962 €, në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës e drejtuar te AKP-ja dhe e ushtruar pastaj në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Suprem më dt. 14.09.2017, duke u mbështetur sipas Ligjit të punës neni 76, pika 7.4 është e pa bazuar me vet faktin se ky ligj nuk ka efekt prapaveprues, pasi paditësit ju është ndërprere kontrata e punës, në kohën kur në fuqi ka qenë Ligji 2001/27.

Po ashtu AKP-ja/AL ka vendosur në lidhje me këtë kërkesë të paditësit dhe paditësit ju janë njohur katër paga, kështu që paditësit me padi të re nuk mundë të kërkojë një kërkesë për të cilën paditësi e ka realizuar në procedurë të likuidimit dhe qëllimi i dëmshpërblimit që është paraparë me ligj nga ligj vënësi është realizuar te paditësi .

Prandaj bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe juridike në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv.

### **Shpenzimet Gjyqësore:**

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do të heqë shpenzimet e veta të procedurës.

### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hasim Sogojeva  
Gjyqtar